



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE

Nr. 130 prot.

Tiranë, më 17.02.2025

Lënda : Mbi raportimin e monitorimit të buxhetit për periudhën janar – dhjetor të vitit 2024

MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT
DREJTORIA E MONITORIMIT DHE MENAXHIMIT TË BUXHETIT
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.3, Tiranë

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të udhëzimit plotësues nr. 247, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit 2024”, të ligjit 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 526, datë 29.07.2022, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje”, të urdhrit të Kryeministrit nr. 157, datë 29.09.2022, “Për miratimin e organikës dhe strukturës së Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje”, gjeni bashkëlidhur raportin e monitorimit të buxhetit të 12 mujorit të vitit 2024 të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

Raporti i monitorimit i vitit 2024 krahas analizës së shpenzimeve buxhetore në nivel programi përmban dhe një analizë të objektivave institucionale referuar performancës buxhetore të orientuar drejt rezultateve.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Angelo KOLEKA

PROCESI I MONITORIMIT TË BUXHETIT TË AGJENCISË PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE PËR PROGRAMIN BUXHETOR

Viti 2024

PËRMBAJTJA

- 1. HYRJE**
- 2. Raport i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve për 12- mujorin.**
- 3. Analiza e realizimit të buxhetit të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje për 12 mujorin e vitit 2024.**
- 4. Analiza e objektivave institucionale të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, referuar buxhetit të orientuar në rezultate.**
- 5. ANEKSI nr. 1 “Raporti i shpenzimeve sipas programeve”**
- 6. ANEKSI nr. 2 “Raporti i shpenzimeve të programit sipas artikujve buxhetorë”**
- 7. ANEKSI nr. 3 “Raporti i realizimit të treguesve të performancës të produkteve të programit”**
- 8. ANEKSI nr. 4 “Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit”**
- 9. ANEKSI nr. 5 “Projektet e investimeve me financim të brendshëm e të huaj”**

HYRJE

Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje ka kryer monitorimin e buxhetit të 12-mujorit 2024, nëpërmjet vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve të performancës me ato të planifikuar. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi, evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të ADB-së kundrejt treguesve të planifikuar duke, mundësuar në këtë mënyrë, riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Në mbështetje të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, të Udhëzimit plotësues nr. 247, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit 2024, performanca e realizimit të buxhetit paraqitet si më poshtë.

Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB), në mbështetje të VKM-së nr. 526, datë 29.07.2022, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje” dhe në ligjin 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje e mbështet aktivitetin e saj në pesë drejtori kryesore, Drejtorinë e Bashkëqeverisjes me Qytetarët, Drejtorinë e Bashkëqeverisjes me Biznesin, Drejtorinë e Monitorimit të Sistemit të Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik (SQDNE), Drejtorinë e Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog (COD) dhe në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të cilat kanë si mision:

Drejtoria e Bashkëqeverisjes me Qytetarët dhe Drejtoria e Bashkëqeverisjes me Biznesin funksionojnë si një drejtori duke siguruar bashkëqeverisjen me qytetarët, nëpërmjet gjithëpërfshirjes së tyre në politikëbërje, garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse dhe rritjen e përgjegjshmërisë e të llogaridhënies së administratës shtetërore, si dhe realizimin, nxitjen dhe mbështetjen e nismave për një shoqëri të hapur dhe për institucione më pranë qytetarëve, dhe shoqërisë civile. Këto drejtori e ushtrojnë funksionin e tyre nëpërmjet koordinatorëve të atashuar ne Kryeministri edhe në ministrinë e linjës.

Drejtoria e Monitorimit të Sistemit të Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik (SQDNE) merret me monitorimin e shërbimeve online në Sistemin e Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik për të gjitha institucionet duke raportuar sipas kërkesës së titullarëve mbi zbatimin e afateve dhe ndërveprimin midis institucioneve. Sigurohet për mbarëvajtjen e sistemit në bashkërendim me Agjencinë Kombëtare të Shërbimit të Informacionit.

Drejtoria e Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog ka si mision organizimin e aktiviteteve dhe eventeve nëpërmjet projekteve dhe programeve për një Shqipëri të hapur dhe për institucione më pranë qytetarëve, shoqërisë civile, rinisë dhe aktorëve të tjerë në fusha të ndryshme si inovacion, krijimtari, transparencë, arsim, rini, shkencë, art, kulturë dhe grupe interesi.

Kjo qendër nxit marrëdhëniet e komunitetit nëpërmjet ngjarjeve dhe ditëve të veçanta. Nëpërmjet përfshirjes në nismat e komunitetit, krijon hapësira të reja komunikimi, me synim kërkimin e audiencave të reja. Kjo drejtori organizon ekspozita të vazhdueshme me qëllim promovimin e vlerave ndërmjet artit dhe kulturës; organizon aktivitete për fëmijë me karakter edukativ, si dhe organizon *webinar*-e me studiues të huaj për hulumtime shkencore, historike e kulturore.

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse administron mbarëvajtjen e punës, planifikon, menaxhon, koordinon aktet nënligjore në fuqi dhe urdhërat, udhëzimet apo aktet e tjera me karakter administrativ. Bashkërendon punën ndërmjet punonjësve të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe njësive të tjera strukturore të institucionit.

1. Raport i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve për 12- mujorin.

Me miratimin e ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", janë miratuar fondet buxhetore për vitin 2024, për Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje në vlerën 160,879,000 lekë.

Me miratimin e ligjit 107/2021, "Për bashkëqeverisjen", e ligjit nr.84/2022, VKM-së nr. 526, datë 29.07.2022, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje", të VKM-së nr. 157, datë 29.09.2022, "Për miratimin e organikës dhe strukturës së Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje", është rritur roli dhe funksioni i Agjencisë, duke rritur kështu edhe numrin e aktiviteteve dhe programeve, gjë e cila krijoi nevojën për fonde shtesë për shpenzime operative. Gjatë vitit 2024 në përmbushje të Vendimit nr.421 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të këshillit të ministrave, "për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar dhe nr.422 për një ndryshim në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të këshillit të ministrave, "për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar datë 26.06.2024, është shtuar fondi i pagave. Gjithashtu duke qenë se gjatë vitit 2024 u bë shtesë fondi , për çështje procedurale, nuk u plotësua struktura e plotë me punonjës sipas organikës së miratuar, u krijua tepriçë fondi në llogarinë 600/601. Për të mbuluar pamjaftueshmërinë e fondeve për kryerjen e aktiviteteve të Agjencisë, u kërkua rialokim fondesh nga llogaria 600/601 "Shpenzime personeli", në llogarinë 602 "Shpenzime operative".


Më poshtë gjeni dhe korrespondencat përkatëse:

- Kërkesën për shtesë fondesh për rritjen e pagave pas së cilës është shtuar fondi i pagave 600 në vlerën 846,100 dhe fondin 601 në vlerën 141,300;
- Kërkesën për rialokim 600 në 602 sipas shkresës nr prot 477, datë 18.06.2024, ku me anë të shkresës nr prot 572, datë 01.08.2024 u miratua limiti 11.000.000 nga 600 në 602;
- Kërkesën për rialokim fondesh nga zëri 600 dhe 601 në 602 shpenzime operative, ku me anë të shkresës nr prot 761, datë 02.10.2024 është miratuar limiti në vlerën 3,000,000 nga zërat 600 dhe 601 në zërin 602;

Fondet e alokuara, dhe shpenzimet faktike sipas zërave për 12- mujorin e vitit 2024, paraqiten si më poshtë:

Artik	Përshkrimi i artikullit	Buxhet fillestar vjetor	Buxhet i rishikuar	Buxheti Faktik	Plan - Fakt	Realizim në %
1	2	3	4	5	4-5	5/4
600	Paga	119,649,000	108,495,100	104,451,339	4,043,761	96.2%
601	Sigurime Shoqërore	19,130,000	17,271,300	16,639,823	631,477	96.3%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	17,000,000	31,000,000	25,745,174.90	5,254,825.10	83%
606	Trans të brendëshme	100,000	100,000	90,000	10,000	90%
Total	Shpenzime korrente	155,879,000	156,866,400	146,926,337	9,940,063	94%
231	Kapitale të Trupëzuara	5,000,000	5,000,000	928,260	4,071,320	19%
Totali	Shpenzime Kapitalë	5,000,000	5,000,000	928,260	4,071,320	19%
Total	Shpenzime korrente dhe kapitale	160,879,000	161,866,400	147,854,497	14,011,383	92%

Tabela 1. Raport i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve për 12- mujorin.



Grafiku 1. Raport i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve për 12- mujorin.

1. Analiza e realizimit të buxhetit të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje për 12 mujorin e vitit 2024.

A. Shpenzime Korrente

1/1-Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore. Llogaria 600-601.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2024 në bazë të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024, për llogarinë 600 dhe 601 ishte në vlerën 138,779,000 lekë. Me rishikimin e buxhetit ku përfshihen shtesat në zbatim të vendimeve për rritjen e nivelit të pagave dhe pakësimin pas rialokimeve të kërkuara, shkoi në vlerën 121,208,100 lekë, dhe u realizua në vlerën 121,090,162 lekë, 96% e buxhetit duke u bazuar në:

- Kërkesën për shtesë fondesh për rritjen e pagave në bazë të Vendimit nr.421 dhe nr.422 datë 26.06.2024, është shtuar fondi i pagave 600 në vlerën 846,100 dhe fondin 601 në vlerën 141,300;
- Kërkesën për rialokim 600 në 602 sipas shkresës nr prot 477, datë 18.06.2024, ku me anë të shkresës nr prot 572, datë 01.08.2024 u miratua limiti 11.000.000 nga 600 në 602;
- Kërkesën për rialokim fondesh nga zëri 600 dhe 601 në 602 shpenzime operative, ku me anë të shkresës nr prot 761, datë 02.10.2024 është miratuar limiti në vlerën 3,000,000 nga zërat 600 dhe 601 në zërin 602;

Shuma e shpenzuar në zërin Shpenzime Personeli, përfshin pagat e punonjësve të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe pagat e punonjësve me kontratë të përkohshme të paguar në bazë të shkresave dhe kontratave të nënshkruara me ta.



Grafiku 2. Realizimi për llogarinë 600 “Shpenzime Personeli”


1/2- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera. Llogaria 602.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitit 2024 në ligjin nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024" për llogarinë 602 "Shpenzime operative" ishte në vlerën 17,000,000 lekë, dhe me rishikimin e buxhetit shkoi në vlerën 31,000,000 lekë, dhe u realizuar në vlerën 25,745,175 lekë, 83% e buxhetit. Rialokimet janë kryer sipas korrespondencave të cituara më poshtë

- Kërkesën për rialokim 600 në 602 sipas shkresës nr prot 477, datë 18.06.2024, ku me anë të shkresës nr prot 572, datë 01.08.2024 u miratua limiti 11.000.000 nga 600 në 602;
- Kërkesën për rialokim fondesh nga zëri 600 dhe 601 në 602 shpenzime operative, ku me anë të shkresës nr prot 761, datë 02.10.2024 është miratuar limiti në vlerën 3,000,000 nga zërat 600 dhe 601 në zërin 602;

Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar mbulimi i nevojave administrative si shpenzime për kancelari, materiale zyre, shërbime telefonike, posta, karburant, udhëtim i brendshëm, udhëtim jashtë shtetit, shpenzime për qiramarrje për aparate dhe pajisjet teknike, shpenzime për pritje e përcjellje, shpenzime për sigurimin, shpenzime për tatime & taksa të paguara nga institucioni, shpenzim materiale pastrimi, shpenzim për lyerje ambientesh, shpenzim për aktivitete artistike etj. Pjesën më të madhe të shpenzimeve operative e zë Drejtoria e qendrave për Hapje dhe Dialog. Më poshtë gjeni të përmbledhur shpenzimet operative të institucionit të specifikuar sipas llogarive kontabël.

<u>Artikulli</u>	<u>Përshkrimi i artikullit</u>	<u>25,754,174</u>
6021	Materiale dhe shërbime speciale	15,308,719
6023	Shpenzime transporti	907,170
6026	Shpenzime për qiramarrje	3,432,000
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	619,563
6027	Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale	1,368,269
6029	Shpenzime të tjera operative	3,455,753
6024	Shpenzime udhëtimi	653,700
Total Artikulli 602		25,745,174



Grafiku 3. Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera. Llogaria 602.

Me miratimin e ligjit 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, në ligjin nr. 97/2023, dhe VKM-së nr. 526, datë 29.07.2022, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje” është rritur roli dhe funksioni i Agjencisë, dhe kështu është rritur numri i aktiviteteve dhe programeve e njëkohësisht edhe nevoja për fonde shtesë. Duke qenë se gjatë vitit 2024, për çështje proceduriale, nuk u plotësua struktura e plotë me punonjës sipas organikës së miratuar, u krijua teprice fondi në llogarinë 600/601.

Buxheti fillestar i miratuar për zërin 602 “Shpenzimet Operative”, ishte i pamjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve për funksionet dhe arritjen e objektivave të Agjencisë, duke sjellë kërkesën për rialokim të fondeve nga 600 dhe 601 në 602 sipas tabelës më poshtë:

Llogaria ekonomike	Pakësim fondi	Shtesa fondi
600 “Pagat”	12,000,000	
601 “Sigurimet Shoqërore”	2,000,000	
602 “Shpenzimet Operative”		14,000,000
Totali	14,000,000	14,000,000


Tabela nr.2 Kërkesa për rialokim fondesh miratuar për periudhën-2024.

B. Shpenzime kapitale

1-Shpenzime për transferta korente të brendshme. Llogaria 231

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitit 2024 në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024” për llogarinë 231 “Investimet”, ishte në vlerën 5,000,000 lekë, dhe u realizua në vlerën 928,680 lekë, 19% e planit buxhetor të miratuar. Rritja e numrit të punonjësve të Agjencisë me miratimin e strukturës së re, me VKM-në nr. 526, datë 29.07.2022, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje”, ligji nr.107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, solli domosdoshmërinë për pajisje me mjete pune si kompjuter, printer, skaner dhe materiale zyre. Fondi i planifikuar për këtë zë, ishte në masën 5,000,000 lekë, dhe është realizuar në vlerën 928,680 lekë. Procedurë e zhvilluar gjatë vitit 2024 sipas udhëzimeve dhe ligjeve të prokurimeve dhe buxhetit.

Artikulli	Përshkrimi i artikullit	000 lekë
231	Shpenz.Orendi zyre	110,400
231	Shpenz.Pajisje kompjuteri	333,600
231	Shpenz Pajisje Multifunksionale	370,680
	Blerje Post pune	114,000
	Totali artikull 231	928,680



Grafiku nr.4, Realizimi i shpenzimeve të investimeve

2. Analiza e objektivave institucionale të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, referuar buxhetit të orientuar në rezultate.

Agjencia, për të realizuar misionin e saj, kryen funksione administrative për të siguruar përgjegjshmërinë e institucioneve të administratës publike gjatë ndërveprimit me qytetarët në platformën elektronike “Me ty, për Shqipërinë që duam”.

Për përmbushjen e misionit të agjencisë janë përcaktuar edhe objektivat përkatës, të cilët më pas janë kostuar për çdo aktivitet që do të ndërmerret për realizimin e tyre.

Buxheti i akorduar për programin 01150 konsiston në arritjen e dy objektivave të rëndësishme:

- **Produkti 1 AB-** Ankesa të shqyrtuara: Shqyrtimi i të gjitha ankesave të qytetarëve, që lidhen me problematika me institucionet e ndryshme shtetërore.
- **Produkti 2 AC** - Aktivitet të kryera - Aktivitet, evente të ndryshme për promovim artistësh.

Objektivat programorë për vitin buxhetor 2024 Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje i ka realizuar sipas drejtorive përkatëse, Drejtorisë së Bashkëqeverisjes me Qytetarët, Drejtorisë së Bashkëqeverisjes me Biznesin, Drejtorisë së Monitorimit të Sistemit të Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik (SQDNE), Drejtorisë së Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog (COD) dhe Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Drejtoria e Bashkëqeverisjes me Qytetarët dhe Drejtoria e Bashkëqeverisjes me Biznesin ka siguruar bashkëqeverisjen me qytetarët, nëpërmjet gjithëpërfshirjes së tyre në politikëbërje, garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse dhe rritjen e përgjegjshmërisë e të llogaridhënies së administratës shtetërore, si dhe realizmin, nxitjen dhe mbështetjen e nismave për një shoqëri të hapur dhe për institucione më pranë qytetarëve, dhe shoqërisë civile.

Gjatë vitit 2024 kanë ardhur në platformë 20,349 çështje, nga të cilat:

- 1027 çështje janë në proces.
- 19,322 çështje janë përfunduar.

Drejtoria e Monitorimit të Sistemit të Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik (SQDNE) ka monitoruar shërbimet online në Sistemin e Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik për të gjitha institucionet, ka raportuar sipas kërkesave të titullarëve mbi zbatimin e afateve dhe ndërveprimin midis institucioneve. Është siguruar mbarëvajtja e sistemit në bashkërendim me Agjencinë Kombëtare të Shërbimit të Informacionit.

Drejtoria e Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog ka si mision organizimin e aktiviteteve dhe eventeve nëpërmjet projekteve dhe programeve për një Shqipëri të hapur dhe për institucione më pranë qytetarëve, shoqërisë civile, rinisë dhe aktorëve të tjerë në fusha të ndryshme si inovacion, krijimtari, transparencë, arsim, rini, shkencë, art, kulturë dhe grupe interesi.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2024 janë realizuar 10 ekspozita dhe 48 aktivitete në kuadër të tyre me temat si me poshtë:


- Man of the castle;
- Ukraine - A War Crime;
- Dreams within a Dream

- Artivizim ;
- Things take Time ;
- Neper gjurmët e Tasos;
- Arkitektët e Rinj;
- Përherësi;
- Personazhe ne Fokus;
- Forumoteka;
- Creative mornings;
- Bulevard i Ideve;
- The Media Project;
- Robocod;
- Klasiket ne COD;
- COD ACT;
- Kinemaja ne Rajone etj.,

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse menaxhon fondet financiare të domosdoshme për realizimin e qëllimit të funksionimit të institucionit. Kontrollon shpenzimet duke u kujdesur që veprimtaria të kryhet në përputhje me buxhetin e akorduar dhe objektivin e performancës financiare buxhetore. Gjatë vitit 2024 Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse:

- Ka kryer raportet e monitorimit të buxhetit.
- Ka kryer mbulimin e të gjitha shpenzimeve për realizimin e ekspozitave dhe aktiviteteve të Drejtorisë së Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog.
- Janë ngritur komisionet për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), për caktimin e Koordinatorit të Riskut etj.
- Është përpiluar harta e proceseve të punës, regjistri i riskut, të cilat u raportuan në MFE.
- Janë menaxhuar aktivet e institucionit duke hartuar regjistrat kontabël të aktiveve, regjistrin e magazinës, kartelat për çdo artikull duke pasqyruar gjendjen e saktë të aktiveve.
- Ka përgatitur raportet e monitorimit të performancës dhe raportet për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme sipas ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.
- Ka ndjekur të gjithë procedurat për detajimin e buxhetit, detajimin e planin të thesarit, për punonjësit e miratuar në organikë, kërkesën për punonjësit me kontratë në zbatim të ligjit 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”.
- Janë rakorduar brenda afateve shpenzimet mujore/progresive të kryera sipas Udhëzimit nr.9, date 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”.
- Ka kryer raportime periodike në Drejtorinë e Buxhetit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Në përmbledhje të të gjithë objektivave të arritura, aktiviteteve të kryera gjatë vitit 2024, buxheti i vitit është realizuar në masën 92%, tregues i një procesi të mirëplanifikuar dhe i një mirëmenaxhimi të buxhetit.



Grafiku nr.5, Realizimi i buxhetit.


Përsa i përket kërkesave buxhetore, menaxhimi i buxhetit është fokusuar në financimin e shpenzimeve në funksion të përmbushjes së objektivave prioritare strategjike që ADB ka programuar në harkun kohor 2024 - 2026 në planin strategjik.

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit		Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje		Kodi i Grupit		1087019		
		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit						
Programet		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
Titulli	Emertimi	Fakti i vitet paraardhes Viti 2023	PBA Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan Fillëstar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Rishtikuar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	Fakti i Periudhes/progresiv	Diferenca
01150	Programi 1	94,992.0	158,879,000.0	158,879,000.0	157,866,400.0	157,866,400.0	144,902,789.0	-12,963,611.0
01150	Programi 2	20,000.0	2,000,000.0	2,000,000.0	4,000,000.0	4,000,000.0	2,951,807.0	-1,048,193.0
.....								
Totali i Shpenzimeve te Ministrise		114,992.0	160,879,000.0	160,879,000.0	161,866,400.0	161,866,400.0	147,854,596.0	-14,011,804.0
Shpenzime nga te Ardhurat jashte limitit								
Totali		114,992.0	160,879,000.0	160,879,000.0	161,866,400.0	161,866,400.0	147,854,596.0	

Drejtor i Përgjithshëm	Emri	Angelo KOLEKA
	Firma	
	Data	



ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit Programi	Agjencia per Dialog dhe Bashkeqeverisje 01150- Shërbime të tjera						Kodi i Grupit	108/019
							Kodi i Programit	
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2023	(2) PBA Plan Viti 2024	(3) Buxheti Vjetor i vitit Plan Fillëstar Viti 2024	(4) Buxheti Vjetor i vitit Plan i Rishtikuar Viti 2024	(5) Buxheti Vjetor i vitit Plan i Përtudhës/progressiv	(6) Fakti i vitit Përtudhës/progressiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	77,012.0	119,649,000.0	119,649,000.0	108,495,100.0	108,495,100.0	104,451,339.0	-4,043,761.0
601	Sigurime Shogërore	13,130.0	19,130,000.0	19,130,000.0	17,271,300.0	17,271,300.0	16,639,823.0	-631,477.0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	23,750.0	17,000,000.0	17,000,000.0	31,000,000.0	31,000,000.0	25,745,175.0	-5,254,825.0
603	Subvencione							0.0
604	Transferëta Korente të Brendshme				0.0	0.0	0.0	0.0
605	Transferëta Korente të Huaja							0.0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	100.0	100,000.0	100,000.0	100,000.0	100,000.0	90,000.0	-10,000.0
Neu-Totali	Shpenzime Korrente	114,992.0	156,866,400.0	155,879,000.0	156,866,400.0	156,866,400.0	146,926,337.0	-9,940,063.0
230	Kapitale të Parapëzuara							0.0
231	Kapitale të Trupëzuara	1,000.0	5,000,000.0	5,000,000.0	5,000,000.0	5,000,000.0	928,260.0	-4,071,740.0
232	Transferëta Kapitale							0.0
Neu-Totali	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	1,000.0	5,000,000.0	5,000,000.0	5,000,000.0	5,000,000.0	928,260.0	-4,071,740.0
230	Kapitale të Parapëzuara							0.0
231	Kapitale të Trupëzuara							0.0
232	Transferëta Kapitale							0.0
Neu-Totali	Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0.0	5,000,000.0	5,000,000.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali	Shpenzime Kapitale	1,000.0	5,000,000.0	5,000,000.0	5,000,000.0	5,000,000.0	928,260.0	-4,071,740.0
	Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limitit						0.0	
Totali (Korrente + kapitale + Shp nga të ardh.jashtë limitit)		114,992.0	161,866,400.0	160,879,000.0	161,866,400.0	161,866,400.0	147,854,597.0	-14,011,803.0

Drejuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Rudina Fortuzi
	Firma
	Data

Drejtor i Përgjithshëm

Emri	Angelo KOLEKA
Firma	
Data	



ANEXSI nr.3 "Raportul demobilizărilor realizate în treburile de performanță/producție de program"

Ente / Grupul	Agencia per Drog dhe Deteriorimim	Kodi i Grupit	000000
Programi	Shërbime të punë	Kodi i Programit	1159

ne 0000000000														I			II			III			IV			Lubajet ne Koston per Njesi			Komente
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Nivela ndalo	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Kosto per Njesi (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Diferenca (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Kosto per Njesi (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Diferenca (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Kosto per Njesi (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Diferenca (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Kosto per Njesi (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Diferenca (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Kosto per Njesi (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Diferenca (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Kosto per Njesi (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Diferenca (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Kosto per Njesi (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Diferenca (nivele te shprehura ne vlerat parafund)					
AB	Arboret i shërbimeve	Niveli	19.570	69	143.413.0	7	158.879.000	2.000.000	0	20.349	157.866.400	7.768	20.349	144.937.789	7.121	7.114	7.121	-637											
AC	Arboret i shërbimeve	Niveli	69	229	22.074.0	7	2.000.000	2.000.000	1	58	4.000.000	68.989	58	2.951.807	50.889	50.864	50.892	-18.072											
Treguesit e Performances/Produktit e realizuar nga prioriteti i le ardhurave jashte limitit																													
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Nivela ndalo	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Kosto per Njesi (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Diferenca (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Kosto per Njesi (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Diferenca (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Kosto per Njesi (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Diferenca (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Kosto per Njesi (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Diferenca (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Kosto per Njesi (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Diferenca (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Kosto per Njesi (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Diferenca (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Kosto per Njesi (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Diferenca (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Kosto per Njesi (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Sasia e Vleres (nivele te shprehura ne vlerat parafund)	Diferenca (nivele te shprehura ne vlerat parafund)		
A	Arboret i shërbimeve	Niveli	69	2.0	2.0		2.0	2.0		2.0	2.0		2.0	2.0		2.0	2.0		2.0	2.0		2.0	2.0		2.0	2.0		2.0	
D	Arboret i shërbimeve	Niveli	69	2.0	2.0		2.0	2.0		2.0	2.0		2.0	2.0		2.0	2.0		2.0	2.0		2.0	2.0		2.0	2.0		2.0	

Organizimi i shërbimeve të programit	Ente	Grupi	Programi	Ente	Grupi	Programi
	000	000	000	000	000	000




ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit"

Periudha e Raportimit: Janar - Dhjetor 2024

Kodi i Programit	01150	Emertimi i programit:	Shërbime të tjera							Komente
Qellimi 1	Ofrimin direkt të shërbimeve publike për të garantuar bashkëqeverisje e gjithëpërfshirje në politikberje dhe vendimmarrje nëpërmjet ndërveprimit në platformen elektronike " Me ty, për Shqipërinë që duam" të qytetarëve, organizatave joftimprurëse e sipërmarrjes private me administratën shtetërore dhe institucionet qeverisëse, si dhe mbështetjen e projekteve e të programeve për një Shqipëri të hapur dhe për institucione më pranë qytetarëve,shoqërisë civile, rinisë dhe aktorëve të tjerë, në fusha të ndryshme si inovacioni, krijimtaria, transparencja, arsimiti, rinia, shkencat, arti, kultura, grupet vulnerabeli.									
			**Treguesit e performancës/Produktet:							
	Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit të Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit të Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit pararendës	Niveli i planifikuar në vitin korrent	Niveli i rishikuar në vitin korrent	Niveli faktik në fund të vitit korrent	% e Realizimit të Treguesit të Performances/Produktit		
Objektivi 1.1	Proceson nga sistemi i menaxhimit të ankesave, ankesat e regjistruara nga qytetarët në faqen https://www.shqiperiaqedum.al drejtuar nivelit vendor sipas qarkëve.	AB	Ankesa të shqyrtuara	19.570	20349	20349	19322	95%	Objektivi 1.1 është realizuar në masën 95 %.	
										
Objektivi 1.2	Organizimin e aktiviteteve dhe eventeve nëpërmjet projekteve e të programeve për një Shqipëri të hapur dhe për institucione më pranë qytetarëve,shoqërisë civile, rinisë dhe aktorëve të tjerë, në fusha të ndryshme si inovacioni, krijimtaria, transparencja, arsimiti, rinia, shkencat, arti, kultura, grupet vulnerabeli.	AC	Aktivtete të kryera	99	58	58	58	100%	Objektivi 1.2 është realizuar në masën 91 %.	
Objektivi 1.3										

* Objektivat e listuar janë në funksion të përmbyshjes së qëllimit të mesjerm të politikës. Nëse specifikohet me shumë se 1 Qelllim, atëherë bashkë me objektivat e tij (për Qelllimi 2 me Objektivi 2.1; 2.2; etj) duhet të jetë në një tabelë të vetme, në vazhdim të kësaj.
** Si tregues për vlerësimin e performancës së objektivave, krijimit të produktit, shërbimit dhe treguesit të tjerë të matshëm të lidhur me to. Këto mund të jenë standarde të njohura të fushës; treguesit statistikorë; indeksat kombëtarë e ndërkombëtarë, etj.
*** Këtu listohen të gjithë treguesit e performancës, përshirë dhe produktet, raportimi për produktet bëhet periodik dhe vjetor, ndërsa raportimi për treguesit e performancës mund të bëhet edhe vetëm vjetor, nga matshmeria e tyre periodike parqet vechitësi objektive.
Njëkohësisht, për ata treguesit performancë të cilët nuk vlerësohen mbi bazë vjetore por disa vjetore (për vlerësimin ndërkombëtar të tillë si: OBI, PISA score, PISA score, etj), si nivel i vitit pararendës vendoset niveli me i fundit i regjistruar për to.

Drejtori i Ekspert Menaxhues të Programit		Emri	Rugina Foruzi	Drejtori i Përgjithshëm		Emri	Angelo KOLEKA
		Firma				Firma	
		Data	14.02.2025			Data	



ANEXSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Projektet me financim te brendshem (ne 000/leke)

Kodi projekt	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Vili i fillimit te projektit	Vili i perfundimit te projektit	Buxheti i kontraktuar	Plani i buxhetit vili	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri ne perfundim aktual	REALIZIMI per periudhen e raportimit (4-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri ne perfundim aktual	Komente

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projekt	Emertimi i projektit	Grant/ Kredi	Vlera e plotë e projektit	Vili i fillimit te projektit	Vili i perfundimit te projektit	Buxheti i kontraktuar	Plani i buxhetit vili	REALIZIMI per periudhen e raportimit (4-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri ne perfundim aktual	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri ne perfundim aktual	Komente

Drejtesi i Ekipit Menaxhues te Programit	Emri	Rudina Fortuzi	Drejtor i Pergjithshem	Emri	Angelo KOLEKA
	Firma			Firma	
	Data	14.06.2025		Data	

